



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2021:215879  
Datë: 30.04.2024  
Numri i dokumentit: 05640617

CAP.nr.1602/2023

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, me gjyqtaren individuale Hidajete Gashi Alaj, në çështjen përmbartimore të kreditorit B.G nga Prishtina, të cilin e përfaqëson F.M Avokat nga Prishtina, ndaj debitorit Shërbimi Spitalor Klinik Universitar i Kosovës, me seli në Prishtinë, duke vendosur lidhur me ankesën e debitores të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Cpc.nr.1101/21, i datës 04.07.2023, me datë 30.04.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET e pathemeltë ankesa e debitorit Shërbimi Spitalor Klinik Universitar i Kosovës, me seli në Prishtinë, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, Cpc.nr.1101/21, i datës 04.07.2023, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prishtinë me aktvendimin, Cpc.nr.1101/21, i datës 04.07.2023 ka vendosur si në vijim:

*“I.REFUZOHET, prapësimi i debitorit të përmbartimit: Shërbimi Spitalor Klinik Universitar i Kosovës, me seli në Prishtinë, i ushtruar kundër Aktvendimit Cpc.nr.1101/21, të dt. 04.05.2023 mbi caktimin e përmbartimit, si i pabazuar.*

*II.OBLIGOHET, debitori i përmbartimit: Shërbimi Spitalor Klinik Universitar i Kosovës, me seli në Prishtinë, që të autorizuarit kreditorit të përmbartimit t’ia kompensoi shumën prej 117.00€, në emër të shpenzimeve për përpilimin e përgjigjes në prapësim.”*

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë debitori për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave procedurale, konstatimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike dhe

zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, duke propozuar që Gjykata e Apelit në Prishtinë të aprovoj ankesën e paraqitur dhe aktvendimin e gjykatës së shkallës së parë ta prishë dhe lëndën ta kthej në rigjykim dhe rivendosje ose të njëjtin ta ndryshoj dhe të hedhë poshtë propozimin për përmbarrim si të pa bazë.

Gjyqtari individual i Gjykatës së Apelit, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3, paragrafi 2, të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbarrimore si dhe në kuptim të nenit 194 të LPK-së, gjeti se:

-Ankesa e debitorit është e pa themeltë.

Nga shkresat e lëndës rezulton se kreditori me datën 22.09.2021, ka paraqitur propozim të përmbarruesi privat për përmbarrimin e borxhit për paga jubilarë në shumë prej 659.00 euro, në bazë të dokumentit përmbarrimor –Vendimi të Inspektoratit të Punës.

Gjykata e shkallës së parë me aktvendimin, Cpc.1101/21, i datës 04.05.2023 ka caktuar përmbarrimin ndaj debitorit.

Kundër urdhrorit të lëshuar nga Gjykata, ka paraqitur prapësim debitorit me propozim që urdhri i lëshuar të ndryshohet dhe propozimi për përmbarrim të hedhet poshtë si i pa bazë.

Gjykata e shkallës së parë me aktvendimin Cpc.nr.1101/21, i datës 04.07.2023 ka refuzuar si të pa bazuar prapësimin e debitorit të ushtruar kundër urdhrorit për lejimin e përmbarrimit të lejuar nga përmbarruesi privat.

Në arsyetimin e aktvendimit të atakuar gjykata e shkallës së parë ka theksuar se pas shqyrtimit të prapësimin, analizimit të shkresave të lëndës, pretendimet në prapësim, i ka vlerësuar si të paqëndrueshme dhe të pabazuara në ligj, për arsye se debitorit i përmbarrimit nuk ka ofruar prova në mbështetje të pretendimeve të tij siç është paraparë me nenin 69 par. 4 të LPP-së, rrjedhimisht nuk janë përmbushur asnjë nga kushtet ligjore për anulimin e aktvendimit mbi caktimin e përmbarrimit, apo shtyrjen e zbatimit të përmbarrimit, të përcaktuara me dispozitat e nenit 61 par 1 pika 1 dhe nenit 71 par 1, pika 1 deri në 12 të Ligjit për Procedurën Përmbarrimore (Ligji nr. 04/L-139), të Republikës së Kosovës.

Me nenin 24 par.3 të LPP-së është rregulluar se: Vendimi i dhënë në procedurë administrative është përmbarrimor, po qe se i tillë është bërë sipas rregullave me të cilat është rregulluar procedura e tillë, ndërsa me par.5 të njëjtit nen është rregulluar se: Përmbarrimi caktohet në bazë të vendimit gjyqësor që ende nuk është bërë i formës së prerë, ose në bazë të vendimit të dhënë në procedurën administrative që nuk është bërë përfundimtar, vetëm po qe se me ligj është paraparë se ankesa apo mjetet tjera juridike, nuk e ndalojnë përmbarrimin.

Në rastin konkret përmbarrimi është caktuar në bazë të dokumentit përmbarrues-Vendimit të Inspektoratit të Punës 01Nr.21-1302/418 të datës 30.03.2020, i cili përcakton saktë shumën të cilën duhet ta përmbush debitorit ndaj kreditorit, dhe është bërë i përmbarrueshëm pasi që kemi të

bëjmë me akt përfundimtar të dhënë në procedurën administrative dhe, që në vetë dokumentin përmbarues është thënë se në bazë të nenit 6.4 të Ligjit nr.2002/9 dhe nr.03/L-17 për Inspektoratin e Punës në Kosovë, ankesa apo mjetet tjera juridike, nuk e shtyn ekzekutimin, ndërsa sa i përket pretendimit të debitorit se dokumenti përmbarues nuk është në origjinal apo kopjet të vërtetuar, një pretendim i tillë është i paqëndrueshëm, pasi që në shkresat e lëndës dokumenti përmbarues është në origjinal.

Vlerësimin dhe qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, Gjyqtari i Gjykatës së Apelit e aprovon si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se aktvendimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m), të LPK-së, dhe se drejtë është zbatuar e drejta materiale, e të cilat shkaqe ankimore gjykata e shkallës së dytë i vlerëson edhe sipas detyrës zyrtare, në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Në ankesën e paraqitur debitori pretendon se gjykata ka bërë shkelje esenciale të dispozitave të procedurës përmbarimore dhe atë duke vepruar në kundërshtim me nenin 24 par.5, nenin 36 par.1, nenin 37 si dhe nenin 38 par.1 të Ligjit për Procedurën përmbarimore, sepse sipas debitorit propozimit për përmbarim nuk i është bashkëngjitur dokumenti përmbarues origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit. Tutje në ankesë debitori thekson se gjykata ka bërë shkelje të dispozitave procedurale sepse debitori ka theksuar se kreditori ende pa përfunduar procedura e ankimit ka parashtruar propozim për përmbarim të vendimit të Inspektoratit të Punës, e kështu sipas debitorit kemi edhe vërtetim të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike pasi që nuk mund të ekzekutohet akti administrativ kundër të cilit është bërë ankim me efekt pezullues.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë duke i vlerësuar pretendimet ankimore të mësipërme të parashtruara nga ana e debitorit, vlerëson se të njëjtat janë të pa bazuara sepse gjykata e shkallës së dytë me rastin e vendosjes nuk ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e Ligjit të Procedurës Përmbarimore sikurse pretendon debitori në ankesë. Gjykata e shkallës së parë nuk ka vepruar në kundërshtim me nenin 24 par.5 të LPP-së i cili përcakton se: *“Përmbarimi caktohet në bazë të vendimit gjyqësor që ende nuk është bërë i formës së prerë, ose në bazë të vendimit të dhënë në procedurë administrative që nuk është bërë përfundimtar, vetëm po që se me ligj është paraparë se ankesa apo mjetet tjera juridike, nuk e ndalojnë përmbarimin”*, e kjo për faktin se përmbarimi është caktuar pikërisht në bazë të vendimit të dhënë në procedurë administrative, pra vendimi është marrë nga Inspektorati i Punës e po ashtu edhe me ligj është paraparë se ankesa nuk e shtyn ekzekutimin e vendimit, e kjo duke u bazuar në dispozitën e nenit 6.4 i Ligjit për Inspektoratin e Punës i cili përcakton se: *“Ankesa e ushtruar në vendimin e Inspektorit të punës nuk e shtyn ekzekutimin e vendimit.”*

Tutje, Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë nuk ka vepruar në kundërshtim me nenin 36 të Ligjit për Procedurën Përmbarimore i cili përcakton vërtetimin për përmbarueshmërinë, ku në paragrafin 1 të këtij neni thuhet se: *“Së bashku me propozimin për përmbarim, organit përmbarues i dorëzohet edhe dokumenti përmbarues, origjinal apo kopje e vërtetuar, me klauzolën e përmbarueshmërisë për përmbarueshmëri”*. Nga shikimi i shkresave të lëndës vërehet se kreditori propozimit për përmbarim i ka bashkëngjitur dokumentin në kopje

të vërtetuar, pra vendimin e Inspektoratit të Punës, 01Nr.21-1302/418 i cili përmban vulën origjinale të organit noterial, që ka vërtetuar se kopja është identik me origjinalin, andaj nuk qëndron pretendimi se propozimit për përmbardim nuk i është bashkëngjitur dokumenti origjinal. Po ashtu, pretendimet se gjykata e shkallës së parë ka vepruar në kundërshtim me nenin 37 dhe 38 të Ligjit për Procedurën Përmbardimore nuk qëndrojnë sepse siç u theksua propozimit për përmbardim i është bashkëngjitur dokumenti në kopje të vërtetuar, e po ashtu propozimi për përmbardim i përmban të gjitha elementet e përcaktuara me nenin 38 duke përmbajtur kërkuesin e përmbardimit dhe debitorin, adresën e kreditorit dhe debitorit, si dhe kredinë që kërkohet të realizohet, kështu që Gjykata e Apelit pretendimet e debitorit se është vepruar në kundërshtim me nenet e sipërcituara nuk mund ti marrë si të bazuara.

Debitori po ashtu pretendon se edhe në bazë të nenit 144 të Ligjit për Procedurën Administrative, akti administrativ ekzekutohet kur hyn në fuqi dhe bëhet i ekzekutueshëm nga vet organi administrativ i cili e ka nxjerrë këtë vendim, ndërsa sipas debitorit vendimi i inspektoratit të punës ende nuk është bërë i ekzekutueshëm. Gjykata e Apelit, vlerëson se edhe ky pretendim nuk qëndron sepse neni 144 i LPA-së, paragrafi 1, nënpar.1.4 përcakton se: *“Një akt administrativ do të bëhet i ekzekutueshëm me: 1.4 njoftimin e palës me aktin e ndalimit të efektit pezullues të ankesës, në pajtim me paragrafin 3 të nenit 386 të këtij Ligji”*, e që organi që e ka nxjerrë vendimin, pra inspektorati i punës e ka njoftuar palën debitore se ankesa kundër këtij vendimin nuk e shtyn ekzekutimin.

Meqenëse debitori me ankesë nuk ka paraqitur asnjë shkak me të cilin do të vërtetonte se ekzistojnë arsyeje të cilat do të bënin dokumentin të pa përshtatshëm për tu përmbarduar, Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejt ka vepruar kur e ka refuzuar prapësimin si të pa bazuar duke vendosur sikurse në dispozitiv të aktvendimit të atakuar, duke e konsideruar vendimin e gjykatës së shkallës së parë të drejtë dhe të ligjshëm.

Nga sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi në kuptim të nenit 77 dhe 17 të LPP-së, lidhur me nenin 208 dhe 209, pika b), të LPK-së.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË  
CAP.nr.1602/2023 me datë 30.04.2024

Gjyqtarja  
Hidajete Gashi Alaj, d.v